



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SHTIMES



MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Nr. i Protokollit: 02/ 789

Datë: 14. 9. 2023

## F T E S Ë

I/e nderuar/a,

Komuna e Shtimes është në proces të organizimit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë për projekt buxhetin e vitit 2024. Për këtë qëllim, kryetari i komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu ka themeluar edhe Grupin Punues për përgatitjen e projekt-buxhetit të komunës për vitin 2024.

Me qëllim të sigurimit të gjithë-përfshirjes me theks në pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme qytetare, Komuna e Shtimes ka planifikuar organizimin e dëgjimeve buxhetore me këto grupe qytetare, përfshirë: gratë, të rinjtë, studentët, personat me aftësi të kufizuar, pensionistët, komunitetet jo shumicë që jetojnë në komunën e Shtimes.

Andaj, me qëllim të angazhimit aktiv dhe planifikimit të buxhetit të komunës bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, Komuna e Shtimes ju fton në këto dëgjime publike buxhetore.

Nr.	Vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data/dita e mbajtjes së dëgjimit	Ora	Vendi
1	Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësura (gra, të rinj, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar etj).	E enjte, 21 shtator 2023	14:00	Salla e Kuvendit të Komunës
2	Dëgjimi Publik i Përgjithshëm me qytetarë të komunës së Shtimes	E premte, 22 shtator 2023	18:00	Salla e Kuvendit të Komunës së Shtimes.

Draft-Planin Buxhetor Komunal për periudhën 2024-2026 mund ta merrni si kopje fizike në Zyrën për Informim ose mund ta shkarkoni nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Shtimes, në linkun: <https://kk.rks-gov.net/shtime/wp-content/uploads/sites/28/2023/09/Draft-Plani-Buxhetor-Komunal-per-periudhen-2024-2026.pdf>

Nëse nuk keni mundësi për të marrë pjesë me prezencë fizike në këtë takim, ju lutem që kërkesat, komentet dhe sugjerimet për Projekt-Buxhetin e vitit 2024, t'i dërgoni në këto e-mail adresa: [lulzim.i.sahiti@rks-gov.net](mailto:lulzim.i.sahiti@rks-gov.net); [bujrat.ferati@rks-gov.net](mailto:bujrat.ferati@rks-gov.net) dhe [gentiana.b.mehmeti@rks-gov.net](mailto:gentiana.b.mehmeti@rks-gov.net).

Ju mirëpresim!



Zyra për Informim  
Lulzim Sahiti